



## SUPPORTING EMPLOYMENT OF YOUNG PEOPLE



This project is funded by the European Union

Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë (APRM) për projektin “Mbështetja për punësimin e të rinjve”, të financuar nga BE-ja, shpall:

### THIRRJE PËR TENDER

#### **për organizimin dhe zbatimin e stërvitjes për përgaditje punësimi dhe aftësitë për kërkim pune të të rinjëve të papunë në suaza të Komponentit D „Stërvitje për përgaditje për punësim dhe aftësitë për kërkim pune”**

Agjencia e Punësimit (APRM) do të ndajë marrëveshje për shërbime lidhur me organizimin dhe implementimin e „**Stërvitje për përgaditje për punësim dhe aftësitë për kërkim pune**” në mbarë territorin e shtetit.

Kjo shpallje publike paraqet thirrje për ofertuesit dhe të interesuarit që dorëzojnë oferta për realizimin e stërvitjeve për:

**Titulli: Komponenta D - „Stërvitje për përgaditje për punësim dhe aftësitë për kërkim pune ”**

Stërvitjet do të organizohen për 1400 të rinj të papunë të moshës deri 29 vjet, së paku që kanë mbaruar arsimin e mesëm, të regjistruar si kërkues aktiv të punës në APRM. Numri i saktë i pjesëmarrësve në secilin qytet/ komunë do të varet nga interesimi i personave të papunë për të marrë pjesë në këto stërvitje.

#### **Procedurat dhe afatet e aplikimit**

Dosja e kompletuar tenderike në formë elektronike është e disponueshme vetëm me plotësimin e formularit të aplikimit që mund të gjendet në ueb faqet siç vijojnë:

- Agjencia e Punësimit (APRM): [www.avrm.gov.mk](http://www.avrm.gov.mk);
- Ministria e Punës dhe Politikës Sociale MPPS): [www.mtsp.gov.mk](http://www.mtsp.gov.mk).

Të gjitha subjektet juridike (provajderët e trajnimit) që janë të interesuar për të marrë pjesë në këtë tender, u bëhet ftesë që t’i dorëzojnë dosjet tenderike dhe të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme që kërkohen. Dokumentet e tenderit patjetër duhet të dërgohen në adresën siç vijon, e cila është dhënë edhe në instruksionet e ofertuesve:

**Agjencia e Punësimit (APRM)**  
**Adresa: Rruga. “Vasil Gjorgov”**  
**nr. 43, 1000 Shkup**

Afata i dorëzimit të ofertave është e hënë 22.05.2017 në orën 16:30.

Tenderi dhe të gjitha dokumentet e kërkuara në dosjen tenderike patjetër duhet të jenë të dorëzuara me anë të sistemit me kuvertë të dyfishtë, përkatësisht paketa ose kuverta e jashtme t’i përmbajë dy kuverta të mbyllura (njërën për ofertën teknike dhe tjetra për ofertën financiare) me këtë tekst: "Supporting



This project is implemented by



**Employment Service Agency**



## SUPPORTING EMPLOYMENT OF YOUNG PEOPLE



**This project is funded by the European Union**

employment of young people "; „Ref.no 12-7741/1-6.5 – Not to be opened before the tender opening session “/ “Të mos hapet para sesionit të hapjes së ofertave” në pjesën e jashtme të kuvertës.

Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara jashtë afatit të mbylljes nuk do të shqyrtohen.

Projekti “Mbështetja e punësimit për të rinjtë” është financuar nga ana e BE-së në suaza të Programit operativ për zhvillimin e burimeve njerëzore 2007 – 2013 (IPA Komponenti IV). Aktivitetet e parapara në këtë projekt do të ndihmojnë për arritjen e qëllimeve të Planit operativ të masave aktive në tregun e punës gjatë vitit 2017.



This project is implemented by



Employment Service Agency